

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 DËLLUQA JE PRAVNOSNAZNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC
NË EMËR TË POPULLIT



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari individualë Elmaz Zenuni, me bashkëpunëtorin profesional Alban Beqiri, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna [REDACTED], i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.473-4/13 të dt.07.08.2013, për shkak se kreu veprën penale vjedhje nga nen. 252 par 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien urdhërit ndëshkimor dënim me gjobë gjykata, me dt.14.10.2013 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTHF-së, PP.nr.473-4/2013 të dt.07.08.2013, gjykata jepë këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna [REDACTED] i lindur më [REDACTED], shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

S E P S E

Me dt. 28.08.2012 në lokalit e tij në fsh.Gjurkocë Komuna Shtime gjatë një kontrolli nga ana e punëtorëve të autorizuar të KEK-ut – Divizioni i rrejtit në Prishtinë-Spektori Qendra e Kalibrit, është zbuluar se me qëllim që vetes të i sjell përfitime pasurore të kundërligjshme, e ka shfrytëzuar energjinë elektrike pa autorizim, në atë mënyrë që është konstatuar se në njëhësi elektrik me nr. 8163041 qelqin e ka thyer (krisur) dhe përmes qelqit nga ana e majtë është futur shiriti Filmik dhe është penguar puna e diskut të njësorit në regjistrimin e energjisë së shpenzuar, në brendi të njësorit elektrik ka pluhur të shiriti filmik, dëmi i shaktuar KEK-ut Divizioni i Rrejtit në Prishtinë-Spektori Qendra e Kalibrimit llogaritur është në shumë prej 1.520,90 €.

me të cilën ka krye veprën penale vjedhje nga nen. 252 par 1 të KPK-së

Andaj konform nenit 3,4,41,46,73, të KPK-së, dhe në bazë të nenit 495 të KPPK-së,

G J Y K O N

Të pandehurin, dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) €, të cilin dënim është i obliguar që të paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera sipas nenit 46 par. 3 të KPPK-së, do ti shndërrohet në dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € do ti llogaritet 1 /një/ ditë burgu.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës KEK-ut- zyra në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 1.520,90 €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguaj, paushallin gjyqësorë në shumë prej 20 €, në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.473-4/2013 të dt.07.08.2013, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR], për veprën penale vjedhje nga neni. 252 par. 1 të KPK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.nr.473-4/2013 të dt.07.08.2013, me arsyetim se ka prova të besueshme nga aktakuza që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 par. 1 të KPPK-së.

Prandaj gjykata duke vlerësuar kallzimin penal e KEK-Distriktit Në Ferizaj- në nr.208/13 të dt.18.03.2013, procesverbali me nr. 01/13 të dt. 13.09.2012, fatura e dt. 22.01.2012, fotografit si dhe provave tjera vërtetojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin sipas ligjit.

Me që në kohën kurë i pandehuri e ka kryer veprën penale ka qenë në fuqi ligji i vjetër, gjykata në mbështetje të nenit 3 të KPK-së, me rastin e shqiptimit të dënimin ka zbatuar ligjin e ri i cili është në fuqi në momentin e dhënies së urdhërit ndëshkimor si ligj më të favorshëm për kryerësin e veprës penale.

Konform nenit 458 të KPPK-së obligoj të akuzuarin që në emër të dëmit të shkaktuar të dëmtuarës KEK-ut zyra në Ferizaj të i kompensoj shumën prej 1.520,90 €.


I pandehuri është i obliguar që të paguaj shpenzimet procedurale, dhe paushallin gjyqësor konform nenit 450 par 2.6 të KPK-së.

Nga arsyet e sipërcekura u vendos si në diaspozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P. nr. 1282/13 të dt. 14.10.2013

Bashkëpunëtori profesionalë

Alban Beqiri



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtës gjykatë.

